

LIGJ
Nr. 11/2013

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 8766, DATË 5.4.2001 “PËR MBROJTJEN
NGA ZJARRI DHE PËR SHPËTIMIN”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 8766, datë 5.4.2001 “Për mbrojtjen nga zjarri dhe për shpëtimin”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Kudo në ligj emërtimi “Ministria e Pushtetit Vendor” zëvendësohet me emërtimin “ministra përgjegjëse” dhe emërtimi “ministri i pushtetit vendor” zëvendësohet me emërtimin “ministri përgjegjës”.

Neni 2

Në nenin 1, pas pikës 5 shtohet pika 6 me këtë përmbajtje:

“6. Inspektimi për verifikimin e respektimit të kërkesave ligjore që burojnë nga ky ligj bëhet në përputhje me ligjin nr. 10 433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, përveç kur parashikohet shprehimisht ndryshe nga ky ligj.”.

Neni 3

Neni 11 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 11

Formimi dhe trajnimi

Punonjësit e PMNZSH-së, krahas formimit dhe trajnimit në kurset pranë Shkollës së Mbrojtjes ndaj Zjarrit dhe në Qendrën e Trajnimit të Emergjencave Civile, u nënshtrohen detyrimisht edhe trajnimeve të tjera, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi në fushën e inspektimit.”.

Neni 4

Në nenin 38 bëhen këto ndryshime:

1. Pikat 1 dhe 2 ndryshohen si më poshtë:

“1. Kur oficeri i inspektim-parandalimit të PMNZSH-së vëren shkelje administrative, për të cilat dispozitat e këtij ligji e ngarkojnë me këto detyra, ai vendos dënimin kryesor me gjobë. Sipas rastit, për të njëjtat shkelje mund të caktohen edhe dënimet plotësuese të “pezullimit” ose të “ndërprerjes së veprimtarisë”.

2. Në rast rrethanash të ngutshme, që e bëjnë të nevojshme marrjen e vendimit përfundimtar, aty për aty, në përfundim të inspektimit, oficeri i inspektim-parandalimit të PMNZSH-së, për shkeljet e detyrimeve të parashikuara në nenin 25, mund të vendosë dënimin me gjobë nga 500 deri në 5 000 lekë. Në të njëjtat rrethana mund të caktohen edhe dënimet e tjera plotësuese.”.

2. Në pikën 3, fjalët “me vendim” hiqen.

3. Në pikën 4, fjalët “oficeri i PMNZSH-së” zëvendësohen me fjalët “oficeri i inspektim-parandalimit të PMNZSH-së”.

4. Pika 6 shfuqizohet.

Neni 5

Neni 39 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 39
Ankimi

Kundër vendimit të oficerit të inspektim-parandalimit të PMNZSH-së mund të bëhet ankim, sipas dispozitave të Kodit të Procedurave Administrative, në organin epror të PMNZSH-së, në ministrinë përgjegjëse. Kundër vendimit të organit epror të PMNZSH-së mund të bëhet ankim në gjykatën kompetente, në përputhje me ligjin për inspektimin.”.

Neni 6

Neni 40 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 40
Ekzekutimi

Ekzekutimi i gjobave dhe masave të tjera administrative, në zbatim të këtij ligji, bëhet sipas legjislacionit në fuqi për kundërvajtjet administrative.”.

Neni 7
Dispozitë kalimtare

Organi ekzistues inspektues vazhdon të ushtrojë funksionin e vet sipas organizimit aktual deri në krijimin e organit të ri, sikurse parashikohet në ndryshimet e bëra në këtë ligj.

Neni 8

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletore Zyrtare.

Miratuar në datën 14.2.2013

Shpallur me dekretin nr. 7970, datë 1.3.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani